



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE  
DEPARTAMENTI I HISTORISË DHE GJEOGRAFISË**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TE STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË**

**"MASTER I SHKENCAVE NË ARKEOLOGJI DHE  
ADMINISTRIMI I PASURIVE ARKEOLOGJIKE"**

**(E përditësuar)**

**Forma e studimit (*me kohë të plotë*)**

**Kredite: (120 ECTS)**

**GJIROKASTËR, Korrik 2020**



**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Objekti dhe baza ligjore e programit të studimit**

1. Rregullorja e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", përcakton kriteret dhe procedurat e Departamentit të Historisë dhe Gjeografisë (DHGJ), për zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin dytë.
2. Hartimi dhe miratimi i rregullores së programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 05.10.2015, "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", (nenet 35, 69, 70, 71, 75, 76, 80, 86, 88, 89, 90, 91 dhe 92 të tij), në Udhëzimin e MASR, Nr.31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterieve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", në VKM Nr.879, datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (FESHSH), si dhe në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër (UGJ).

Rregullorja e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", është hartuar në përputhje me rezultatet e të nxenit si dhe me planin mësimor të tij.

Kjo rregullore është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe studentëve.

**Neni 2**

**Qëllimi i rregullores së programit të studimit**

Kjo rregullore ka si qëllim të njohë dhe të ndihmojë studentët të perceptojnë më qartë përbajtjen e programit të studimit dhe i jep mundësinë atyre të përvetësojnë sa më me efektivitet dijet gjatë studimeve të tyre. Gjithashtu, kjo rregullore synon të specifikojë dhe të përcaktojë qartë disa procedura thelbësore për studimin në këtë program studimi, me qëllim që të arrihet asimilimi sistematik i njohurive dhe zhvillimi sa më i madh i aftësive praktike, që do ta bëjnë të diplomuarin në këtë program studimi të aftë për t'iu përgjigjur nevojave bashkëkohore në drejtim të administrimit të pasurive kulturore, historike dhe arkeologjike.


**Neni 3**

**Të dhëna të përgjithshme**

Të dhënat e përgjithshme për Programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 1. Të dhëna të përgjithshme të Programit të Studimit*

Emërtimi i programit të studimit	"Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike"
Cikli i studimeve:	I dytë
Lloji i programit:	"Master i shkencave"



Totali i Krediteve (ECTS):	120 ECTS
Kohëgjatja normale në vite	2 (dy) vite akademike
Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
Gjuha e studimit:	shqip
Departamenti përgjegjës	Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë
Fakulteti përgjegjës	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shqërore
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	Fakulteti Ekonomik, Akademia e Studimeve Albanologjike, Institut i Arkeologjisë
Institucione të huaja të arsimit të lartë	-
Subjekte të tjera publike apo private	-

**Neni 4****Rezultatet e të nxënësit dhe karakteristikat e programit të studimit**

Programi i ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", forma e studimit me kohë të plotë, 120 ECTS, synon njohjen me:

- ✓ aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe operative, që lidhen me sektorët e arkeologjisë dhe të historisë së artit antik, duke iu referuar në mënyrë të veçantë tematikave që ofrojnë trevat si shqiptare dhe ato jashtë;
- ✓ aftësi në sektorët e administritmit, konservimit dhe restaurimit të pasurive arkeologjike, artistike, dokumentare, monumentale etj;
- ✓ aftësi në përdorimin e mjeteve informatike dhe të komunikimit elektronik, për të përpunuar monumentet dhe sitet arkeologjike, për të bërë klasifikimin e gjeljeve dhe trajtimin e pamjeve (*imazheve*), si dhe për të bërë administritmin informatik të materialev të shkruara;
- ✓ aftësi për të përdorur në mënyrë të rrjedhshme, të shkruar dhe të folur, të paktën një nga gjuhët e Bashkimit European.

Viti i parë, konsiston në konsolidimin e njohurive mbi teoritë e studimit arkeologjik, të studimeve bashkëkohore në arkeologji, metodave të thelluara të studimit arkeologjik, studimit arkeologjik të shoqërive protourbane dhe urbane, të antikititetit të vonë dhe mesjetës, të etnoarkeologjisë, letërsisë greko-romake, prehistorisë së Shqipërisë, etj.

Viti i dytë, i dedikohet thellimit teorik dhe aplikativ, në fushën e arkeologjisë, duke u mbështetur në parimet e administritmit të pasurive arkeologjike, në aplikimin e njohurive të fituara në fushën e arkeologjisë, në realizimin jo vetëm të praktikës në terren, të realizuar në sitet dhe parqet arkeologjike të Rajonit Jugor, por edhe më gjërë, por gjithashtu edhe të punimit diplomës, që t'i jetet studentit mundësia për të përfituar një përvojë dhe pavarësi, që e përgatit atë për ecjen përpara / ngritjen profesionale.

Një diplomë universitare me titull: "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", është mjaft fleksibël përsa u përket mundësive që kanë studentët për punësim, si specialistë që mund të punësohen në:

- ✓ Zyrat teknike të enteve publike: Ministria e Kulturës, Qarqet e retheve, Bashkitë etj.
- ✓ Institucionet e lidhura me ruajtjen, menaxhimin dhe studimin e pasurisë arkeologjike.
- ✓ Instituti i monumenteve të kulturës, drejtori të rajonale të monumenteve të kulturës, parqet arkeologjike, zyrat e trashëgimisë kulturore, Akademia e Studimeve Albanologjike, Institut i Arkeologjisë etj.
- ✓ Në organizmat private që kanë për objekt studimin dhe menaxhimin e vlerave arkeologjike.
- ✓ Në universitete vendëse dhe të huaja, që kanë për objekt studimi historinë, arkeologjinë, trashëgiminë kulturore etj.



Qëllimi i këtij programi është të ofrojë një formim profesional dhe shkencor përmes rjoburive komplekse, të cilat, në tërësinë e tyre, fokusohen tek shkenca e arkeologjisë dhe menaxhimi i pasurive arkeologjike, historike dhe kulturore. Këto rjoburi do t'i shërbejnë studentëve të diplomuar jo vetëm në aspektin e punësimit në tregun kombëtar dhe vendeve të BE-së, por edhe si bazë për të transferuar kreditet e grumbulluara gjatë studimeve të kryera në studimet e ciklit të dytë në këtë degë apo të tjera të ngashme me të.

### Neni 5

#### Veprimtaritë formuese të programit të mësimit

- Në DHGJ, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë programin e studimit, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: mësim në auditor (*leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor*), studim individual (*studim dhe punim relacionesh detyrash apo projektesh*), përgatitje për provime, përgatitje e punimit të diplomës, veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.
- Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:
  - ✓ *Lëndë bazë* të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
  - ✓ *Lëndë karakterizuese*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe jepin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij dhe përgatitje për disiplinën shkencore;
  - ✓ *Lëndë ndërdisiplinore* dhe/ose *integruese* në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, nëndisiplina, profile të programit dhe gruplendë me zgjedhje;
  - ✓ *Lëndë plotësuese*, të fokusuara në përfshimin e aftësive të gjuhëve të huaja, rjoburive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim.
  - ✓ *Detyrime përbyllëse*, që lidhen me përgatitjen e punimit të diplomës.
- Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese në programin e studimit, e shprehur në përqindje të krediteve të alokuara, sipas llojit të programit, paraqitet në Tabelën 2.

Tabela 2. Struktura e planit mësimor dhe lista e lëndëve mësimore të Programit të Studimit

Format e veprimtarive mësimore	VITI I PARË			
	Semestri I		Numri i vlerësimeve sipas semestrave	
	Javët	Javët	Semestri I	Semestri II
Mësim	15	15	-	-
Provime	3	3	4	4
Praktikë në terren	-	-	-	-
Tezë diplome				-
<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>4</b>

Format e veprimtarive mësimore	VITI I DYTË			
	Semestri I		Numri i vlerësimeve sipas semestrave	
	Javët	Javët	Semestri I	Semestri II
Mësim	15	-	-	-
Provime	4	-	6	-
Praktikë në terren	-	6	-	1
Tezë diplome	-	9	-	1
<b>Gjithsej</b>	<b>19</b>	<b>15</b>	<b>6</b>	<b>2</b>



Nr.	LËNDËT VITI I (i parë)	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese				Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda						Provine	ECTS	
		Kategoria/ Tipi i komponentit mësimor	Gjithsej orë	Ore gjithsej në auditor	Ore studimi individual	Ore në javë	Leksi	Seminare	Ore në javë	Leksi	Seminare			
1.	Teoria e studimit arkeologjik dhe studime bashkëkohore në arkeologji	A	200	90	110	6	4	2	-	-	-	P	8	
2.	Histori e mendimit arkeologjik	B	200	90	110	6	4	2	-	-	-	P	8	
3.	Metoda të thelluara të studimit arkeologjik	B	200	90	110	-	-	-	6	4	2	P	8	
4.	Arkeologjia e shoqërive protourbane & urbane	B	200	90	110	-	-	-	6	4	2	P	8	
5.	Letërsi Greko-Romake	B	175	75	100	5	3	2	-	-	-	P	7	
6.	Arkeologji e antikitetit të vonë dhe mesjetës	B	175	75	100	5	3	2	-	-	-	P	7	
7.	Prehistoria e Shqipërisë	B	175	75	100	-	-	-	5	3	2	P	7	
8.	Etnoarkeologjia	B	175	75	100	-	-	-	5	3	2	P	7	
Gjithsej Viti I (i parë)				1500	660	840	22	14	8	22	14	8	8	60

Nr.	LËNDËT VITI II (i dytë)	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese				Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda						Provine	ECTS			
		Kategoria/ Tipi i komponentit mësimor	Gjithsej orë	Ore gjithsej në auditor	Ore studimi individual	Praktikë në terren	Ore në javë	Leksi	Seminare	Ore në javë	Leksi	Seminare	Praktikë në terren			
1.	Prehistoria e Ballkanit	B	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6	
2.	Civilizimi Bizantin	B	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6	
3.	Parime të administritmit të pasurive arkeologjike	C	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6	
4.	Gjeopullimi në lashtësi	C	75	30	45	-	2	1	1	-	-	-	-	P	3	
5.	Gjeografia e qytetërimeve të lashta	C	75	30	45	-	2	1	1	-	-	-	-	P	3	
6.	Lëndë me zgjedhje -Arkeologjia e provincave Romake -Numizmatika -Mitologjia	C	150	60	90	-	4	3	1	-	-	-	-	P	6	
7.	Praktikë në terren	D	300	-	150	150	-	-	-	-	-	-	-	300	12	
8.	Tezë diplome	E	450	-	450	-	-	-	-	-	-	-	-	-	18	
Gjithsej Viti II (i dytë)				1500	300	1050	150	20	14	6	-	-	-	300	7	60
Gjithsej Viti I (i parë) dhe Viti II (i dytë)				3000	960	1890	150	42	28	14	22	14	8	300	15	120



**KREU II**  
**PRANIMI I STUDENTËVE**

**Neni 6**

**Kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve**

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", kandidatët që:
  - ✓ kanë përfunduar me sukses dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të arsimit të lartë, të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërtë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
  - ✓ janë diplomuar në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit, në një program të ciklit të parë të studimeve. Në çdo rast pranimi, kandidati duhet të ketë kryer ekuivalentimin e diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), për licensimin dhe akreditimin e saj, në përputhje me legjislatinon shqiptar.
2. Në studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", pranohen:
  - ✓ pa njohuri plotësuese, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë, nga fusha të njëjtë ose të përafërtë, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë, të shprehur në kredite është jo më pak se 70%:
    - "Bachelor" në Histori;
    - "Bachelor" në Arkeologji;
    - "Bachelor" në Trashëgimi kulturore;
    - "Bachelor" në Histori-Gjeografi;
    - "Bachelor" në Histori dhe Gjuhë Italiane;
    - si dhe kandidatë që kanë kryer studimet në universitetet e huaja, në fushën e historisë, arkeologjisë, trashëgimisë kulturore.
  - ✓ me plotësim të njohurive, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë: "Bachelor" ose Diplomë e Nivelit të Parë nga fusha të përafërtë, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%.

Plotësimi i njohurive formuese bëhet në përputhje me Rregulloren e FESHSH-së, të UGJ-së dhe me këtë rregullore të programit të studimit.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i çertifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkuesave dhe kuotave të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse, përparsi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë. Ky kriter do të jetë i rivlerësueshëm çdo vit akademik, në varësi të studentëve konkurrues.



## Neni 7

### Procedurat për pranimin e studentëve

1. Procesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", organizohet nga Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (FESHSH), Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë (DHGJ) si dhe menaxhohet dhe monitorohet nga Rektorati i UGJ-së.
2. Procesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", zhvillohet në përputhje me kuadrin ligor në fuqi, duke respektuar udhëzimet e MASR, si dhe procedurën e përvkruar në Rregulloren e FESHSH-së dhe të UGJ-së.
3. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar të paktën një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të të përcaktuar në Rregulloren e FESHSH-së dhe të UGJ-së, si dhe në këtë rregullore.
4. Rendita e aplikantëve bëhet në bazë të mesatares së rezultateve të ciklit të parë të studimeve të diplomës "Bachelor" dhe në përputhje me kriteret e tjera të vendosura nga DHGJ, ku prioritet kanë aplikantët që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në të njëjtën fushë në UGJ-së.
5. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të njëjta ose të përaferta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, pranohen pa kredite në debi, në programin e studimit të ciklit të dytë.
6. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përaferta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, pranohen me kredite debi, në programin e studimit të ciklit të dytë. DHGJ përcakton komponentët mësimorë, që duhet të japë kandidati, në funksion të njojurive pararendëse, që ai duhet të ketë, për të ndjekur programin përkatës të studimit. Numri total i krediteve shtesë për plotësimin e njojurive të tyre nuk duhet të jetë më i madh se 30 kredite. Detyrimet që i lindin aplikantit të shpallur fitues, kur vijnë nga fusha studimi të afërta, i komunikohen aplikantit përparrë regjistrimit të tij.
7. FESHSH dhe UGJ mund të njohe kredite të përfituarë në programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i shkencave", në përputhje me kornizën ligore në fuqi duke respektuar procedurat, kërkosat dhe Rregulloren e FESHSH-së dhe UGJ-së, si dhe të kësaj rregulloreje studimi.

## Neni 8

### Transferimi i studimeve

DHGJ ofron mundësi për njojen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtë cikël studimi, brenda UGJ-së, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë publike ose private, vendëse ose të huaja, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitetë të tjera, sipas procedurave të parashikuara në Udhëzimet e MASR-së, në Rregulloren e FESHSH-së, si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UGJ-së.

Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja dhe ekuivalentimi i krediteve bëhet nga DHGJ, pranë të cilit është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve.



### Neni 9

#### Kushtet për transferimin e studimeve

- Transferimet bëhen brenda të njëjtë cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjtë ose të përafërtë dhe vetëm në fillim të vitit akademik. DHGJ ofron mundësinë e transferimit të studimeve nga programe të sistemeve të mëparshme të studimeve universitare në UGJ në programe të ciklit të dytë të studimeve. Transferimi i studimeve bëhet për studentët që kanë filluar studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" në fusha të afërtë studimi.
- Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtë cikël studimi, brenda UGJ-së apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:
  - ✓ ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen;
  - ✓ plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga DHGJ;
  - ✓ në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- Njohja e plotë të krediteve të fituara nga një student që transferohet, bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe në këtë rregullore të programit të studimit.

### Neni 10

#### Procedurat për transferimin e studimeve

- Procedurat për transferimin e studimeve fillojnë në përputhje me Udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik.
- Kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të FESHSH, dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar në Udhëzimet e MASR-së, në Rregulloren e FESHSH-së dhe në atë të UGJ-së.
- Studenti që transferon nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, listën e notave, planin e plotë të programit dhe syllabuset përkatëse, duhet t'i dorëzojë ato të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të njësuara me origjinalin.
- Sekretaria mësimore e FESHSH ndjek të gjithë praktikën sipas udhëzimit të MASR mbi procedurat e aplikimit të kandidatëve.
- DHGJ ose FESHSH mund të vendosin kritere specifike për pranimin e transferimit të studimeve, të cilat miratohen në Dekanat. Kriteret e pranimit shpallen publikisht me fillimin e procesit të transferimeve në FESHSH-UGJ.

### Neni 11

#### Njohja e krediteve

- Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", në FESHSH-UGJ, bëhet nga DHGJ, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Rregulloren e FESHSH-së dhe të UGJ-së si dhe në këtë rregullore.
- Njohja e lëndëve dhe krediteve bëhet duke patur parasysh kreditet dhe programin e lëndës si dhe notën e marrë.
- Lënda ekuivalentoher kur:
  - ✓ ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën e programit të studimit ku transferohet;
  - ✓ trajton tema të njëjtë ose të ngjashme si dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës që zhvillohet në programin e studimit në DHGJ.



- Në funksion të numrit të krediteve të njohura, përcaktohet viti ku do të rregistrohet studenti, si dhe numri i lëndëve dhe krediteve që duhet të plotësojë studenti në përputhje me programin e studimit ku është pranuar.

### Neni 12

#### Njohja e krediteve të fituara në programet "Master" dhe "Master profesional"

- DHGJ mund të njohë si kredite të realizuara për programin e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", kreditet e fituara në programet "Master" dhe "Master profesional", kur ato janë në përputhje me objektivat specifike të këtij programi studimi.
- Njohja e krediteve realizohet nga komisioni ad-hoc *i njohjes dhe ekuivalentimit*, me të paktën 3 anëtarë, i cili pas verifikimit të sasisë së krediteve dhe orëve të zhvilluara, për programet lëndore me të njëtin emërtim ose të përafërtë, të zhvilluar në programin e ciklit të dytë "Master profesional", merr vendimin mbi sasinë e krediteve të njohura, të cilin ia përcjell pëmiratim dekanit të FESHSH-së.
- DHGJ nuk njeh si kredite të realizuara për një program studimi të ciklit të dytë, kreditet e fituara në çfarëdo program studimi të ciklit të parë.

### Neni 13

#### Ndjekja e një programi të dytë studimi

- Studentët që kanë kryer një program studimi të ciklit të dytë, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, në të njëtin cikël studimi, në përputhje me Udhëzimet e MASR-së, në kriteret e pranimit të përcaktuara në Rregulloren e FESHSH-së dhe UGJ-së, si dhe në këtë rregullore studimi.
- Procedurat e aplikimit për program të dytë studimi bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## KREU III

### ORGANIZIMI I STUDIMEVE

### Neni 14

#### Organizimi i studimeve

- Studimet në FESHSH-UGJ zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga Ministri, përgjegjës për Arsimin e Lartë. Viti akademik përfshin mësimdhënien, sesionin e provimeve dhe sesionin e mbrojtjes së diplomave. Mësimdhënia organizohet në dy semestra. Kohëzgjatja normale e një semestri është 15 javë mësimore.
- Organizimi i mësimdhënieve, i sesionit të provimeve dhe i sesionit të mbrojtjes së diplomave, shprehet në strukturën mësimore, e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UGJ-së, në fillim të çdo viti akademik.
- Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike", ofrohet në gjuhën shqipe.

### Neni 15

#### Organizimi i procesit të mësimit

Viti akademik shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve të MASR-it (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe mbrojtje punim diplome/provim përfundimtar).



Fillimi dhe përfundimi i vtit akademik përcaktohet me Udhëzim të MASR-it në çdo fillim viti akademik. Si rregull mësimi zhvillohet nga dita e hënë deri në ditën e premte me jo më shumë se 25 orë mësimore në javë. Veprimitaria mësimore është organizuar në 2 (dy) semestra me nga 15 javë, sesionet e rregulla të provimeve të dimrit, të verës dhe sesionin e vjeshtës. Çdo semestër zgjat 15 javë për mësim dhe jo më shumë se 4 javë për provime. Datat e sakta të kohëzgjatjes së mësimit, pushimeve dhe provimeve përcaktohen dhe shpallen nga DHGJ dhe janë të parashikuara në Strukturën e Vtitit Akademik. Me fillimin e vtitit akademik DHGJ shpalli orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për semestrin përkatës. Në program janë parashikuar lëndët si dhe kreditet përkatëse, po ashtu dhe organizimi i tyre në orë mësimore dhe studim individual. Shpërndarja e kreditit është bërë referuar akteve nënligjore. Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion programet (*syllabuset*) për çdo lëndë që ofrohet. Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon disiplinat mësimore, i cili organizon kontrollle me gojë, me shkrim, detyra të pavarura etj, në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në Rregulloren e DHGJ-së, në Rregulloren e FESHSH-së dhe të UGJ-së si dhe në planet e programet mësimore të lëndëve. Kohëzgjatja e orës së mësimit është 50 minuta. Nën përgjegjësinë e njësisë bazë organizohen edhe aktivitete të tutoriatit për studentët në përputhje me rregullat e përcaktuara në planet e punës së departamentit.

### Neni 16

#### **Format specifike të mësimdhënieve, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti**

1. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të pasqyruar në planet mësimore, në programet e lëndëve.  
*Format kryesore të punës mësimore janë:*
  - ✓ format e mësimit teorik dhe praktik, ku përfshihen: leksionet, seminaret, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, projekt – diplomat etj;
  - ✓ format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, niveli i diskutimit në seminare, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, provimin përfundimtar të lëndës, mbrojtje e temave të diplomave etj.
2. DHGJ mund të propozojë edhe forma të tjera të punës mësimore, që janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit, veçanërisht ato të kontrollit të dijeve të fituara. Propozimet për format e reja bëhen para fillimit të viti të ri akademik dhe pasqyrohen në planin mësimor të programit të studimit si dhe në programet e lëndëve (*syllabuset*), së bashku me informacionet për ngarkesën mësimore, për orët në auditor/jashtë auditorit, për frekuentimin/ndjekjen e programit dhe për formën e kontrollit të dijeve.
3. Format e kontrollit të dijeve (*punë laboratorike, marrje/mbrojtje e detyrave, marrje/mbrojtje e projekteve*), reflektohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilët hartohen nga DHGJ.
4. Kalendar i këtyre formave të kontrollit të dijeve shpallet jo më vonë se dy javë pas fillimit të semestrit.
5. Kontrolli i dijes së një lënde, e cila realizohet gjatë sesionit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet:
  - ✓ provimit me shkrim;
  - ✓ provimit me gojë;
  - ✓ vlerësimit të projektit;
  - ✓ kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt etj.



6. Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet duke përdorur sistemin shqiptar të vlerësimit me 10 (*dhjetë*) nota, nga 1 (një)-shi tek 10 (dhjetë)-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (*pesë*).
7. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.
8. Personeli akademik përgjegjës i lëndës që është provim, përcakton sipas natyrës së saj, mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm në programin e lëndës (*syllabusin*) dhe e pasqyron edhe në regjistrin e pedagogut. Këto mënyra iu bëhen të ditura studentëve ditën e parë të fillimit të procesit mësimor të lëndës përkatëse. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit për lëndët e programit mësimor përfaqëson 20% të vlerësimit total. Rezultatet e vlerësimit të vazhduar ju bëhen të ditura studentëve me mbarimin e procesit mësimor të lëndës përkatëse, përparrë provimit. Llogarita e vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve të Rregullores së UGJ.

### Neni 17

#### Detyrimet specifike që lidhen me frekuentimin

1. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënieve së lëndëve të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar *me zgjedhje* dhe *të detyrueshme*.
  - ✓ Frekuentimi i leksioneve nuk është i detyrueshëm, ndërsa frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 80% të numrit të seancave të zhvilluara.
  - ✓ Frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 80%.
2. Për format e mësimit me frekuentim të detyruar dhe me zgjedhje, kur studenti me ose pa arsy, nuk merr pjesë në mbi 20% të numrit të seancave të zhvilluara në një lëndë, shpallet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të shlyejë detyrimet e mëtejshme të asaj lënde. Ai ka të drejtë të hyjë në provimin e asaj lënde në sesionit të vjeshtës apo sesionet pasardhëse. Ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimit në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.

### Neni 18

#### Kërkesat specifike për organizimin e praktikës në terren

1. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 80% të orëve të praktikës në terren. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e kompanisë/institucionit pritës.
2. Gjatë kryerjes së praktikës në terren, pedagogu përgjegjës që e drejton atë, mban lidhje me kompaninë/institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës në terren, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur në departament. Vlerësimi bëhet me notë.
3. Në rastet kur studenti për arsy objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën në terren, është i detyruar të shlyejë detyrimin e praktikës në sesionet pasardhëse.
4. Çdo student në semestrin e dytë të vitit të dytë të programit të studimit do të ndjekë praktikën në terren. Gjatë praktikës studenti zgjeron dhe aplikon njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mëjdisi praktik profesional, në kuadër të programit të studimit, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore. Studentët e këtij programi studimi, duhet ta kryejnë praktikën formuese në fushën e kërkimeve dhe studimeve arkeologjike, në sitet arkeologjike të Rajonit Jugor, të Qarkut të Gjirokastër, por edhe të gjërë.



### Neni 19

#### Plani mësimor

- Tërësia e veprimtarive formuese shprehet në *planin mësimor*, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilin parashtohen në mënyrë të përbledhur sa më poshtë vijon:
  - ✓ Emërtimi i programit të studimit, viti akademik, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për të, fusha e studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, forma e përbilljes së studimeve dhe struktura mësimore e programit të studimit.
  - ✓ Tërësia e komponentëve mësimorë (*lëndëve*), që përbëjnë programin e studimit, të grupuara në semestra dhe të renditura sipas semestrave.
  - ✓ Kreditet (ECTS) për çdo komponent mësimor, shpërndarjen e krediteve brenda një lënde, sipas komponentit të saj mësimor (*leksione / ushtrime / seminare / laboratorë / detyra / projekte etj*), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, mënyra e vlerësimit të lëndës.
- Hartimi / rishikimi i planit mësimor bëhet sipas procedurës së përshkruar në Rregulloren e FESHSH dhe të UGJ-së.

### Neni 20

#### Programi i lëndës (syllabuset)

- Programi i lëndës (*syllabi*) hartohej për çdo lëndë që përmban plani mësimor, duke u bazuar në Udhëzimet përkatëse të MASR-së.
 

*Në programin e lëndës jepen në formë të përbledhur:*

  - ✓ të dhënat e përgjithshme për lëndën, emërtimi i lëndës, titullari / pedagogu i lëndës, ngarkesa e lëndës (me kreditet, numrin e orëve mësimore në klasë, të leksioneve dhe seminareve, praktikave etj), viti akademik / semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës (e detyrueshme / me zgjedhje), programi i studimit, adresa elektronike e titullarit/ pedagogut të lëndës, kodi i etikës etj;
  - ✓ përbledhje dhe rezultatet e të nxenit, që duhet të ketë fituar studenti, ku jepet një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës, të cilat janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës;
  - ✓ konceptet themelore, të cilat janë koncepte dhe termi bazë mbi të cilat ndërtohet lënda;
  - ✓ temat e lëndës përbajnë shpjegimin (*rreth një paragraf*) të çdo teme të leksionit sipas javëve, të shoqëruar me literaturën përkatëse (*të detajuar me fage*);
  - ✓ forma e kontrollit të dijeve përbëhet nga frekuentimi dhe kontrolli i vazhdueshëm, ku në këtë të fundit renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminar, kolokumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimit përfundimtar etj, të cilat do të përdoren si parakusht për hyrjen në provim dhe mënyra e vlerësimit përfundimtar;
  - ✓ literatura paraqet listën e botimeve që studentët duhet të lexojnë gjatë lëndës, e ndarë në: literatura bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar;
  - ✓ vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, është hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka, si edhe elementet e Kodit të Etikës sipas pikës 2.10, të këtij vendimi.
- Programi i lëndës hartohej nga titullari i lëndës, ose grup lektorësh të lëndës si dhe miratohet në DHGJ në fillim të çdo viti akademik.



3. Titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimor, jepin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë ndryshime në programin e lëndës.

### Neni 21

#### Literatura bazë e detyrueshme (*tekstet bazë*)

Lista e botimeve të teksteve bazë, që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, propozohet nga anëtarët e personelit akademik, para fillimit të vitit të ri akademik, shqyrtohet në DHGJ dhe miratohet nga Dekani i FESHSH-së.

### KREU IV

### DIPLOMIMI I STUDENTËVE

### Neni 22

#### Kërkesat specifike për diplomimin e studentit

1. Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike" përbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike".
2. Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.
3. Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin, bibliotekën shkencore, bibliotekën kombëtare, konviktet, etj.
4. Punimi i diplomës së ciklit të dytë të studimeve është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit, në formën e një projekti apo studimi me karakter përgjithësues në fushën e historisë, trashëgimisë kulturore, arkeologjisë e administrimit të pasurive arkeologjike etj.
5. Teza e diplomës përmban detyra dhe kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime e projekteve në fushën e arkeologjisë.
6. Punimi i tezës së diplomës kryhet në semestrin e IV (e katërt), nga përfundimi i studimeve.
7. Studenti ka të drejtë të propozojë temën e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqësin e tij.
8. Studenti zhvillon punimin e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar në DHGJ.
9. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërtë të realizimit të tij.
10. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë, sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studenti.
11. DHGJ organizon tre kontolle të ndërmjetëm, nëpërmjet të cilëve kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj. Përgjatë këtyre kontrolleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të punimit, të cilat nuk përbysin thelbin e punimit. Studenti dhe udhëheqësi mund t'i marrin parasysh rekomandimet e komisionit të kontrollit.
12. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur punimin, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës dhe ka kryer kontrolllet në DHGJ.



13. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit, duke firmosur punimin e diplomës.
14. Drejtuesi i DHGJ, plotëson fletën e kontrollit të punimit të diplomës, në të cilën regjistrohet kontrolli i kryer dhe vlerësimi me fjalë për të.

### Neni 23

#### Modaliteti i punimit të diplomës

1. Punimi i diplomës duhet të ketë në strukturën e tij:
  - ✓ qëllimin e studimit, abstraktin (shqip / anglisht);
  - ✓ pjesën teorike; materialin dhe metodat;
  - ✓ rezultatet, diskutimet, përfundimet, falenderimet dhe literaturën.

Pjesa teorike duhet të trajtojë çështje teorike në funksion të temës, që të ndihmojë sqarimet dhe të dhënat e përftuara gjatë etapave të punës eksperimentale. Në tërësi ky kapitull nuk duhet të jetë më shumë se rreth 1/3 (*një e treta e gjithë punës*), kurse rreth 2/3 (*dy e treta*), duhet ti përkasë pjesës së punës individuale të kandidatit (materiali dhe metodat, rezultatet, diskutimet, përfundimet etj). Punimi i diplomës, paraqitet në format A4 dhe respekton rregullat e shkrimit standart akademik.

### Neni 24

#### Diplomimi

1. Mbrotja e tezës së diplomës realizohet në dy sesione për mbrojtjen e diplomave: në verë dhe vjeshtë, në përputhje me strukturën akademike si dhe duke respektuar procedurën përkatëse të përshkruar në këtë rregullore.
2. Mbrotja e diplomës është publike dhe realizohet para komisionit të diplomimit, i përbërë nga 3 (*tre*) – 5 (*pesë*) anëtarë. Anëtarët e komisioneve për mbrojtjen e diplomave duhet të janë me grada shkencore dhe tituj akademikë dhe propozohen nga Përgjegjësi i DHGJ-së dhe miratohen nga Dekani i FESHSH-së.
3. Në përfundim të çdo seance të mbrojtjes së punimeve të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij.
4. Kur studenti vlerësohet me notë pozitive, FESHSH-UGJ e pajis studentin e sapodiplomuar me diplomën "*Master i shkencave në arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike*", të shoqëruar me Suplementin e saj.
5. Suplementi i diplomës hartoherët në përputhje me kërkesat e *Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë*. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, dhe fushën e punësimit. Përbajtja dhe forma e suplementit përcaktohen në Statutin e UGJ-së, në përputhje me udhëzimet e MASR-së.
6. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën punimit të tij, ai mund të rimbrojë të njëjtin punim ose të mbrojë një punim të ri, në një afat kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal të studimeve, të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.



**KREU V**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 25**

Rregullorja e programit të studimit "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike" është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet në fillim të vitit të ri akademik dhe synon përmirësimin dhe përditësimin e elementeve të ndryshëm të saj. Rishikimi bëhet mbi bazën e propozimeve që mund të vijnë nga anëtarët e Departamentit të Historisë dhe Gjeografisë (DHGJ), duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi.

**Neni 26**

Çdo çështje, që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e FESHSH-së dhe të UGJ-së. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë DHGJ i përcjell Dekanatit dhe Rektoratit propozimin përkatës të Departamentit.

**Neni 27**

Rregullorja e programit të studimit "Master i shkencave në arkeologji dhe administrimi i pasurive arkeologjike" është miratuar nga personeli akademik i DHGJ, më 10.07.2020.

